



Prishtinë, 13 prill 2018
Kodi i ZRRE-së: V_970_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_898_2017 të datës 16 mars 2017 të lëshuar shoqërisë "Monten" Sh.p.k., me të cilën ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Llapi 2, në Lokacionin ZK Brecë, me kapacitet të instaluar prej 0.80 MW, Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës, dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Llapi 2, në Lokacionin ZK Brecë, me kapacitet të instaluar prej 0.80 MW, Komuna e Podujevës, të datës 08.03.2018, të shoqërisë "Monten" Sh.p.k., me adresë: Rruga "Arkitekt Karl Gega", 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 13 prill 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Monten" Sh.p.k., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_898_2017 i datës 16 mars 2017, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final, për ndërtimin e HC Llapi 2, në Lokacionin ZK Brecë, me kapacitet të instaluar prej 0.80 MW Komuna e Podujevës, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht deri me 16 shtator 2018.
- II. Shoqëria "Monten" Sh.p.k., obligohet që brenda këtij afati të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Llapi 2, në Lokacionin ZK Brecë, me kapacitet të instaluar prej 0.80 MW, Komuna e Podujevës, gjegjësisht deri me datën 16 shtator 2018 duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- III. Pas skadimit të afatit të cekur në pikën I. të dispozitivit, Vendimi V_898_2017 i datës 16 mars 2017 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfugizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.



Arsy e tim

- o ZRRE, me datë 31.01.2017 nga shoqëria “Monten” Sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Llapi 2, në Lokacionin ZK Brecë, me kapacitet të instaluar prej 0.80 MW, Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 16 mars 2017 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_898_2017, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohej me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- o Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_898_2017, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- o Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse.
- o Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar se aplikuesit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Furnizuesit Publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.
- o Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (1) një vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë “Monten” Sh.p.k., do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- o Aplikuesi “Monten” Sh.p.k., me datë 08.03.2018 ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: *me pranimin e autorizimit preliminar kanë kompletuar dokumentacionin dhe kanë aplikuar për Kushte Urbanistike dhe Leje të ndërtimit në Komunën e Podujevës, me projektet ideore dhe të zbatimit për HC Llapi 2, mirëpo komuna në mungesë të stafit për të shqyrtuar aplikacionin deri më tani nuk ka kthyer përgjigje me shkrim edhe pse verbalist janë dakorduar për lëshimin e lejeve dhe janë në pritje të lëshimit të vendimit me shkrim për dhënien e lejes nga komuna e Podujevës.*
- o *Po ashtu ka theksuar se janë bërë të gjitha përgatitjet buxhetore dhe planifikimet e fillimit të punimeve posa të ju lëshohet leja e ndërtimit dhe autorizimi final. Kanë negociuar me prodhuesin e turbinave dhe kanë arritur marrëveshjen për furnizim, instalim dhe lëshim në punë të HC Llapi 2, është negociuar me fabrikën e tubacionit dhe kanë arritur marrëveshjen paraprake për furnizimin me tubacion, është përzgjedhur kompania e cila do të ndërtoj ndërtesën e hidrocentralit, dhe veprën e marrjes.*
- o *Arsyeja e kërkesës për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së autorizimit preliminar V_898_2017 i datës 16 mars 2017, është se komuna e Podujevës pas zgjedhjeve Lokale ende nuk i ka konsoliduar drejtorit dhe nuk ka zgjedhur drejtorët e departamenteve në mënyrë që të iu*



lëshohet leja e ndërtimit edhe përkundër aprovimeve verbale dhe mirëpritjes së realizimit të projektit në fjalë, ku janë në pritje që me rastin e parë të pajisen me lejen ndërtimore.

- *Andaj, duke pasur parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së, që të gjejnë mbështetje për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së autorizimit preliminar edhe për gjashtë (6) muaj, me qëllim që kompania të siguroj dhe të pajiset me leje të ndërtimit nga komuna e Podujevës dhe pas lëshimit të autorizimit final për ndërtimin e këtyre kapaciteteve, kompania do t'i realizoj projektet në afatin e paraparë ligjor.*
- *Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë 'Monten' Sh.p.k., dhe dëshmive të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar atë dhe ka konsideruar se për shkak të arsyeshmërisë së bazuar dhe të kompleksitetit të sigurimit të lejeve të lëshuara nga institucionet relevante, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.*

IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Podujevës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.